



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 5348

Tirane, date 31/07/2015

Drejtuar: Z.KASEM GALLA & ARDI KALLÇAKU
SHOQERIA "ALB - XHOI" SH.P.K
LAGJIA NR.5 RRUGA "ISLAM DANI"

POGRADEC

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1212 date 07.07.2008.

Te nderuar zotërinj,

Shoqëria "Alb - Xhoi" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1212 date 07.07.2008, për mineral hekur- nikeli, Pogradec, ne Qarkun Korçe.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 2036 date 09.02.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) nr.953 date 10.02.2015 e shkresën nr. 3778 date 03.04.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr.3078 date 07.04.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.1212 date 07.07.2008, për mineral hekur- nikeli, Pogradec, ne Qarkun Korçe, për arsye se:

- Nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2011-2012, për vitin 2012-2013 dhe vitin 2014-2015.
- Keni ndërprere punën për me shume se një vit pa njoftuat me pare strukturat përgjegjëse siç përcaktohet ne ligjin nr. 10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Leja juaj është dhënë me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur ne germën "c" e germën "ç" te pikës 1 te nenit 47 (neni qe përcakton shkeljet ligjore për te cilat një leje revokohet) te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave te revokimit te lejes minerare te shfrytëzimit nr.1212 date 07.07.2008, për mineral hekur- nikeli, Pogradec, ne Qarkun Korçe, qe shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do te merret vendimi për revokimin e lejes nr.1212 date 07.07.2008.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

